



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

13 Nr. Zyrtar – 2021

Me datë: 23.04.2021

Rahovec

Nr. I prot. 1636 Më 23.04.2021
Br. prot. 21
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-48, për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L -222 dhe Ligjit Nr.04/L -116 nenit 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr.03/L-040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës,28/2008), nenit 5,7 dhe 8 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve Nr.1427 e datës 28.04.2017, dispozitat e nenit 8, 10, 12 dhe 16 të Rregullores MF-Nr 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74, dhe nenit 92, paragrafi 4, të statutit të Komunës Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe Thirrjes Publike të datës 19.02.2021, bazuar në Vendimin Nr.221/187 të datës 22.03.2021, për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e Subvencioneve në sport nga DKRS-ja për vitin 2021, Komisioni Vlerësues nxjerr këtë:

VENDIM

1. Në përputhje me afatet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues, të përcaktuara me rregulloret e lartëcekura dhe vendim të Kryetarit të Komunës, dhe mbi bazën e thirrjes publike të datës 19.02.2021, Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha aplikacionet dhe dokumentacionin përkatës të dërguar nga OJQ – të, ku sipas kriterëve, Komisioni Vlerësues ka shpallur fitues për Subvencionim këto OJQ dhe Individ në Sport.

LISTA PRELIMINARE E PËRFITUESËVE NGA SUBVENCIONE NË SEKTORIN E SPORTIT - 2021

Nr.	EMRI I OJQ / INDIVIDËVE TË REGJISTRUAR	TITULLI I PROJEKTIT	BARTËSI I PROJEKTIT	NUMRI I PROTOKOLIT	ADRESA
1.	KLUBI I BASKETBOLLIT "RAHOVECI"	Zhvillimi i aktiviteteve një vjeçare të klubit të basketbollit të Rahovecit – KB "Rahoveci"	Alban Rama	1003	Rahovec
2.	KLUBI I FUTBOLLIT "RAHOVECI"	Inkuadrimi në ligën e parë të Kosovës	Burim Dula	1024	Rahovec
3.	KLUBI I FUTSALLIT "RAHOVECI 2019"	Zhvillimi i kampionatit 2021-2022	Vahid Krasniqi	993	Drenoc
4.	KLUBI I HENDBOLLIT "RAHOVECI"	Të rinjtë në lojën e hendbollit	Bejtullah Deliu	1010	Rahovec
5.	SHOQATA E PEDAGOGËVE TË KULTURËS FIZIKE	Garat sportive dhe zbulimi i talentëve të rinjë	Admir Mullabazi	1016	Rahovec
6.	KLUBI I FUTBOLLIT "XËRXA"	Aktiviteti sportiv futbollistik	Fadil Bytyqi	1015	Xërxë
7.	KLUBI I FUTBOLLIT "BASHKIMI"	Zhvillimi i garave në futboll 2021	Milaim Krasniqi	968	Krushë e Madhe
8.	KLUBI I FUTBOLLIT "DEINI"	Sporti dhe rekreacioni për të rinjtë	Labinot Berisha	1023	Dejnë
9.	KLUBI I FUTBOLLIT "ANADRINI"	Futbolli Anadrinas 2021	Behar Bytyqi	995	Ratkoc
10.	KLUBI I SHAHUT "RAHOVECI"	Kampionati ekipor dhe individual i Kosovës në shah për vitin 2021	Sabahudin Kollari	942	Rahovec
11.	KLUBI I ÇIKLIZMIT "RAHOVECI"	Promovimi i çiklizmit në komunën e Rahovecit dhe përfqësimi në gara.	Ferat Durguti	1004	Rahovec
12.	INCIATIVA POZITIVE	Streetball "Kokrra" 2021	Destan Kërçagu	979	Rahovec
13.	KLUBI I FUTSALLIT "RAHOVECI"	Futsalli sport për të rinjtë	Alfred Cena	952	Rahovec
14.	KLUBI I PESHKIMIT "AMUR"	Organizimi i dy garave në peshkim	Adnan Hoxha	949	Rahovec

15.	AUTO MOTO CARTING	Zhvillimi i artizanateve për vitin 2020-2021	Samir Durguti	1103	Rahovec
16.	SHKOLLA E BASKETBOLLIT "HALIT HOXHA"	Basketbolli me grupmoshat e reja	Altin Selmançena	1017	Rahovec
17.	SHKOLLA E SHAHUT "GANI DAKA"	Kampionati ekipor i Kosovës në shah 2021 (vajza)	Besjana Sokoli	943	Rahovec
18.	SHKOLLA E FUTBOLLIT "DRENOCI"	Shkolla e futbollit "Drenoci"	Aslan Kastrati	906	Drenoc
19.	SHKOLLA E FUTBOLLIT "RAHOVERI"	Zhvillimi dhe edukimi i futbollistëve të ri nga mosha 7 vjeçare deri 17 vjeçare	Fadil Dula	1021	Rahovec

Pas kalimit të afatit të ankesave dhe të procedurave të tjera të parapara në rregulloret e lartëcekura, Kryetari i Komunës do të nënshkruajë kontratat me përfituesit e mjeteve financiare me të gjitha OJQ-të, dhe individët përfitues të regjistruar si OJQ.

Arsyetim

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ – të dhe Individ në Sport, brenda afatit të përcaktuar dhe në përputhje me rregulloret e lartëcekura si dhe mbi bazën e thirrjes publike të datës 19.02.2021, ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni, ku nga 22 aplikacione të pranuar, kriteret i kanë plotësuar 19 prej tyre dhe janë refuzuar 3 aplikacione për shkak të dokumentacionit jo të kompletuar dhe mos përmbajtjes së kriterëve të Thirrjes Publike për OJQ-të dhe Individ.

Refuzimi i aplikacioneve të individëve të cilët kanë aplikuar në thirrjen për Aplikim për subvencionimin në fushën e sportit është bërë pasi që të njëjtët nuk kanë paraqitur dëshmi se janë të regjistruar si OJQ sipas legjislacionit në fuqi.

Të gjitha palët e pakënaqura me punën e Komisionit për listën finale të lartëcekur nga Sporti, mund të ushtrojnë ankesë te komisioni për shqyrtimin e ankesave për subvencione në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në afat prej 5 (pesë) ditë pune, nga data e publikimit të kësaj liste finale në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe Web-faqen e Komunës.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi lejohet ankesë në afat prej 5 ditësh nga dita e shpalljes së tij në tabelën e shpalljeve dhe në Web-faqen e Komunës. Ankesa parashtohet pranë Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ankesave të OJQ –ve dhe Individëve të regjistruar në Komunën e Rahovecit.

- Ankesat dorëzohen me shkrim në sportelin nr.7 në katin e parë në objektin e Komunës.

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve:

1.Qemajl Krasniqi - Kryesues	
2.Edin Shtavica - Anëtar	
3.Ardian Rama - Anëtar	
4.Feriz Thaqi - Anëtar	
5.Saranda Rama - Anëtare	